



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 328 Prot.

Tiranë, më 21. 01. 2025

**Lënda:** Realizimi i detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për periudhën janar-dhjetor 2024.

MINISTRISË SE EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
TIRANE

Në mbështetje të pikës 6, gërma c, të VKM nr. 325 datë 18.05.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, Ju përcjellim realizimin e detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për periudhën janar-dhjetor 2024

- 1. Arritja kryesore gjate vitit 2024. Kalimi me sukses i vlerësimit (peer review) të Sistemit të Menaxhimit për permbushjen e kërkesave të ISO IEC 17025:2017 dhe të CIPM MRA dhe marja e besueshmerisë nga EURAMET pas vlerësimit dhe raportimit të performancës 5 vjecare të SMC, pranë Komitetit Teknik për Cilësinë të EURAMET**

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka kaluar me sukses vlerësimin (peer review) të Sistemit të Menaxhimit për permbushjen e kërkesave të ISO IEC 17025:2017 dhe të CIPM MRA dhe marjen e besueshmerisë nga EURAMET pas vlerësimit dhe raportimit të performancës 5 vjecare të SMC, pranë Komitetit Teknik për Cilësinë të EURAMET.

Rivlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DPM nga organizata evropiane e metrologjisë EURAMET ka qenë një nga objektivat madhore të Sektorit të Sigurimit të Cilësisë si dhe të vetë DPM-së për vitin 2024. Në zbatim të rregulloreve të EURAMET, rivlerësimi u regjistrua si projekt i EURAMET me numër 1605, i kordinuar nga, me pjesmarrjen e vlerësuesve teknik Në përgatitjen e rivlerësimit periodik të DPM-së në mbledhjen vjetore të Komitetit Teknik për Cilësinë të EURAMET, vlerësimi në terren nga ekspertë nga EIM (Greqi), UME (Turqi) dhe INRIM (Itali). Kryevlerësuesi D. Kyrikidis, përfaqesues i Institutit Grek të Metrologjisë EIM, vlerësoi Sistemin e Menaxhimit sipas ISO 17025:2017 dhe CIPM MRA, ndërsa dy ekspertë

teknikë z. Y. Durgut nga Institutit Turk, UME dhe Z. A. Malenga nga Institutit Italian i Metrologjisë, INRIM, vlerësuan laboratorët e presionit dhe masës dhe vëllimit, respektivisht. Vlerësimi u realizua në periudhën 22-23 Janar dhe 6-8 Shkurt 2024. Ky vlerësim u realizua në përputhje me kërkesat e dokumentit CIPM MRA-G-12 të Konferencës Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave dhe EURAMET "Udhëzues për vizitat në terren nga kolegët në kuadër të CIPM MRA" (G-TCQ- PRC-006).

Rezultatet e rivlerësimit u raportuan në Komitetin Teknik për Cilësinë të EURAMET, i cili u mbajt, në Delft Hollandë, në datat 19 - 22 Mars 2024. Pjesëmarrja e DPM-së në këtë mbledhje ishte me shumë rëndësi për arsye të ri-vlerësimit 5-vjecar të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DPM-së, kjo në funksion të vazhdimësisë së plotësisë të kriterëve të anëtarësimit në EURAMET si dhe të ruajtjes së CMC-ve të publikuara në databazën ndërkombëtare, të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave, CIPM MRA. DPM prezantoi SMC në datë 20 Mars 2024. Ky raportim rezultoi me sukses për performancën 5 vjecare të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17025:2017 si dhe të Marrëveshjes Nderkombëtare të Njohjes së Ndërsjelltë të etaloneve kombëtare të matjeve dhe certifikatave të kalibrimit, të Komitetit Ndërkombëtar të Peshave dhe Masave, CIPM MRA. Prezantimi vjen si detyrim pas kalimit me sukses të auditimit të SMC të DPM nga ekspertë të organizatës evropiane të EURAMET-it, në periudhën Janar - Shkurt 2024. Në përfundim të prezantimit dhe pas vlerësimit të raportit të dorëzuar para këtij takimi, Komiteti Teknik për Cilësinë unanimisht konfirmoi besueshmërinë e Organizatës Evropiane në SMC të DPM-së.

## **2. Iniciativat legjislative, aktet nënligjore**

Eshte ridërguar për miratim rregullore e brendshme e DPM-së dhe ka nisur komunikimi për dërgimin e akteve të tjera nënligjore si urdhëri i Ministrit për miratim tipi, udhëzimi i tarifave, urdhër Ministri për shenjë dalluese në mbështetje të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë"

Gjithashtu ka nisur dhe është në proces draft vkm për mundësinë e kryerjes së procesit të kalibrimit të etaloneve jashtë procedurave të tenderimit.

## **3. Procesi i Integritit European dhe bashkëpunimi me të tretët, bashkëpunimi me institucionet e huaja**

-Në kuadër të Procesit të Integritit European dhe si pjesë e kapitullit 1, përfaqesuesit e DPM-se kane qene pjese takimeve dhe pregatitjes se materialeve te ndryshme ne lidhje me:

- Planin e Veprimit për përputhshmerine me nenet 34-36 TFBE
- Progres raportin, Kapitulli 1- Kontributet sipas afateve kohore, shkurt 2024, 24 prill - 01 shtator 2024.
- Përgatitjen e Pozicionit Negociues, Kapitulli 1 - Cluster 2.

-Në kuadër të projektit "Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) Albania, Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës" dhe aktivitetëve të perbashketa me institucionet e infrastruktures të cilësive janë realizuar:

-Workshop dhe vizite studimore në datat 31 janar - 02 shkurt 2024 në METAS, Zvicër sipas axhendes të planifikuara

- Takim kordinues online me METAS, UNIDO, DPM ne date 25 Mars 2024
- Tryeze e rumbullaket - Grate qe influencojne cilesine dhe standarde''organizuar ne date 7 Mars 2024.
- Bashkepunim me strukturat e UNIDO dhe METAS per pergatitjen e nje roadmap-i per DPM-ne.

#### **4. Objektivat strategjike zbatimimi dhe monitorimi i tyre, strategjitë e reja, strategjitë ndërsektoriale**

Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjisë është pjesë e strategjisë ndërsektoriale miratuar me VKM Nr. 326, datë 29.5.2024 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030".

Gjithashtu gjate vitit 2024 ka pregatitur edhe planin e veprimit të aktiviteteve te saj ne dokumentin e permbledhur te Infrastrukturës të Cilësisë për periudhen 2024-2030, iniciuar nga MEKI.

#### **5. Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas ISO 17025 dhe CIPM MRA, Zgjerimi i SMC në laboratore/fusha të tjera, në përputhje me prioritetet/planin e veprimit të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale**

Pas kalimit me sukses e ri-vlerësimit të SMC nga EURAMET, nuk u pa e e nevojshme të kishte rishikim të procedurave operacionale të përgjithshme të SMC, por u evidentua nevoja e rishikimit të një pjese të konsiderueshme të procedurave teknike ose e hartimit të procedurave të reja në disa nga laboratorët e Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale. Sektori i Sigurimit të Cilësisë ka rishikuar procedurat teknike që janë hartuar apo rishikuar nga sektorët/laboratorët e DMSHI, në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017, si dhe në përputhje me prioritetet e planit vjetor 2024 të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, konkretisht:

- 1) **LGJ-PT-01** Procedurë teknike për pajisjet e Laboratorit të Gjatësisë, version 02 datë 12.02.2024
  - 2) **LGJ-PT-02** Procedurë teknike për gjurmueshmërinë e matjeve në Laboratorin e Gjatësisë, version 02 date 23.02.2024
  - 3) **LGJ-PT-03** Procedurë teknike për organizimin dhe kushtet ambientale të Laboratorit të Gjatësisë, version 02 date 12.03.2024
  - 4) **LGJ-PT-04** Procedurë teknike për kalibrimin e blloqeve fundore me metodën e krahasimit mekanik, version 06 datë 25.03.2024
  - 5) **LE-PT-10** procedurë teknike për kalibrimin e rezistencave me multimeter dixhital Fluke 8508A, version 01 datë 15.01.2024
  - 6) **LV-PT-01** Procedurë teknike për kalibrimin e instrumenteve vëllimore me metodën gravimetrike, version 08 datë 23.03.2024
  - 7) **LV-PT-02** Procedurë teknike për kalibrimin e instrumenteve volumetrike që operojnë me piston, version 07 datë 29.05.2024
  - 8) **LV-PT-02** Procedurë teknike për kalibrimin e instrumenteve volumetrike që operojnë me piston, version 08 DATË 04.11.2024
- Grupi i Menaxhimit të Riskut i ngritur me Urdhërin nr. 9 datë 04/01/2019, ka rishikuar statusin e veprimeve të ndermarra me qëllim eliminimin apo minimizimin e rrisqeve bazuar në

metodologjinë e përshkruar në procedurën operationale DPM-PO-23, si dhe ka plotësuar regjistrin e Rrishtit & planin e trajtimit të rrishteve (DPM-FO-23/2\_12.01.2024) të cilat u prezantuan dhe miratuan në mbledhjen vjetore të rishikimit të menaxhimit dhe kanë qenë objekt rishikimi, në vartësi të aktiviteteve të ndërmarra gjatë gjithë vitit 2024.

- Sektori i Sigurimit të Cilësisë ka punuar në mënyrë sistematike për të plotësuar dhe mirëmbajtur regjistrimet e nevojshme të cilësisë dhe ato teknike, bazuar në Politikën e Cilësisë dhe procedurat e dokumentuara të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. Këto regjistrime lidhen me personelin (paanshmërinë, konfidencialitetin, kompetencën teknike, trainimet autorizimet, programi vjetor i trainimeve) auditimet e brendëshme, pajisjet (inventari i pajisjeve, plani i mirëmbajtjes, programi i kalibrimeve për vitin 2024, regjistri i softuare dhe harduare për çdo laborator të DMSHI, programi afatgjatë i pjesëmarrjes në ndërkrahime laboratorike, aftësitë matëse dhe kalibruese të laboratorëve, etj).
- Bazuar në Programin vjetor të auditimeve të brendëshme DPM-FO-06/1\_16.01.2024 janë realizuar auditimet e brendëshme në laboratorët e DMSHI, të cilat kanë pasur për qëllim:
  - a) Verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e ISO/IEC 17025: 2017 dhe CIPM MRA;
  - b) Zgjerimin e fushave që zbatohen kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë; si dhe
  - c) Mbledhjen e informacionit për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të SMCGjetjet e konstatuara dhe evidentuara nga të gjithë auditimet e brendëshme janë regjistruar në raportin e auditimit të brendshëm sipas formatit DPM-FO-06/4, si dhe në regjistrin e jo-konformiteteve, dhe veprimeve korigjuese DPM-FO-09/2. Labororet e DMSHI kanë filluar të implementojnë veprimet korigjuese përkatëse për një pjesë të tyre, ndërkohë që pjesë e konsiderueshme pritet që të zgjidhen gjatë vitit 2025. Më në detaje në lidhje me gjetjet e auditimeve të brendëshme raportohet në raportin vjetor të rishikimit të menaxhimit për vitin 2024.

#### **6. Marrëveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit**

Gjatë vitit 2024 janë negociuar dhe është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me:

-Universitetin e Vlorës

dhe është në proces ajo me:

-Inspektoriatin Shtetëror të Mbikqyrjes të Tregut (ISHMT)

#### **7. Tregues të veprimtarive monitoruese, rezultatet për vitin 2024**

Sipas planeve të punës të miratuara për planet e sektorëve të shërbimeve dhe kalibrimeve të realizuara nga labororet e DMSHI-se, numri i instrumenteve matëse të planifikuara për t'u kontrolluar ishte 41300 dhe janë realizuar 41124 instrumente matëse, me realizim 99.6 %, ndërsa treguesi i të ardhurave ishte planifikuar në masën e 72 000 000 lekë, por janë realizuar 73 300 000 të ardhura (pa TVSH), me realizim 102 %.

Referuar Urdherit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 149, datë 19.05.2022, personave juridike dhe fizike që janë ose autorizohen sipas vendimeve përkatëse administrative nga DPM ju kryhen monitorime të vazhdueshme të performancës së tyre. Gjatë vitit 2024 është nxjerrë 1 (një) vendim administrativ, nr. 1 (nr.1446/5 prot), datë 11.09.2024 "Për verifikim të matësve të energjisë elektrike". Në zbatim të planit vjetor për kryerjen e vizitave monitoruese në subjektet e autorizuar nga DPM, gjatë vitit 2024 janë kryer 13 (trembedhjetë) vizita monitoruese.

## 8. Informacion përmbledhës mbi veprimtarinë e Këshillit të Metrologjisë, për vitin 2024

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 10, të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”, VKM-së nr.152, datë 11.03.2022 “Për përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Metrologjisë”, urdhërave të Ministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) me nr.260, datë 23.11.2022 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Metrologjisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë” dhe nr.297, datë 29.12.2023 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 260, datë 23.11.2022 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Metrologjisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, Këshilli i Metrologjisë gjatë vitit 2024 është organizuar dhe ka zhvilluar 2 (dy) mbledhje, me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të tij, duke përmbushur misionin dhe qëllimin e organizimit të funksionimit të tij.

Këshilli i Metrologjisë, përbëhet nga përfaqësues të 12 (dymbëdhjetë) institucioneve, si organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, me qëllim këshillimin për përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit të metrologjisë, zhvillimin e ruajtjen e politikave kryesore, të strategjive dhe parimeve funksionale të DPM-së, si dhe sigurimin e ruajtjen e paanshmërisë së saj.

Mbledhja e parë e Këshillit të Metrologjisë, për vitin 2024, u zhvillua më datë 08.02.2024, e cilësuar, më tepër si takim prezantues për institucionin e DPM, si dhe u theksua rëndësia e mbledhjes së tij, pasi ka ndikim të veçantë për Metrologjinë. Kjo mbledhje kishte si program, prezantimin mbi aktivitetin e DPM-së, realizimin e objektivave gjatë vitit 2023 dhe plani i vitit 2024, si dhe çështje të tjera diskutimi nga pjesëmarrësit. Temat e diskutuara, sugjerimet e dhëna dhe forcimi i bashkëpunimit në vazhdimësi mes strukturave, ishin në fokusin e takimit, duke e konsideruar këtë të fundit mjaft i frytshëm.

Mbledhja e radhës e Këshillit të Metrologjisë, u mbajt më datë 25.07.2024, në të cilën u trajtuan dhe diskutuan me të pranishmit, arritjet e DPM për 6-mujorit të I të vitit 2024 dhe objektivat e 6-mujorit të II. Rëndësi të veçantë pati diskutimi për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi mes institucioneve të infrastrukturës së cilësisë, e cila mund të trajtohet si plani pune, në të cilin identifikohen nevojat institucionale, për të mundësuar miratimin e tij me urdhër ministri. Gjithashtu, u diskutua edhe dokumenti/udhërrëfyesi 5-vjeçar, që po përgatitet nga DPM mbi gjithë aktivitetin e saj, mbështetur nga Instituti Zvicerian i Metrologjisë (METAS). Në fokusin e diskutimit ishte forcimi i bashkëpunimit mes strukturave, për plotësimin e nevojave të tregut, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe tejkalimin e sfidave, në kushtet e një tregu konkurrues.

Gjatë këtij viti është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), lidhur me përditësimin e anëtarësisë së Këshillit, si dhe për arsye të ndryshimit të pozicioneve të punës jashtë institucionit përfaqësues, janë bërë 2 (dy) kërkesa për ndryshim anëtarë në Këshillin e Metrologjisë, konkretisht nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilat më pas janë përcjellë në MEKI, për miratimin e këtyre ndryshimeve më Urdhër Ministri.

## 9. Forcimi i kapaciteteve administrative

Punonjësit e DPM-se kanë marrë pjesë në workshope, seminare dhe trajnime të organizuara me mbështetjen e buxhetit të shtetit, kryesisht në aktivitete të EURAMET-it (komitete teknike), pjesëmarrje në Asambleenë e Përgjithshme të Eurametit, WELMEC si dhe të projektit të UNIDO. (Projekti - Programi Global i Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) Albania i fokusuar në "Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës për bimët medicinale, aromatike dhe fruta perimet").

Gjithashtu punonjës të DPM-se kanë qenë pjesë e aktiviteteve të Projektit "EU4 Biznesi: Nxitja e tregut të përbashkët rajonal përmes infrastrukturës cilësore dhe e-commerce" e fokusuar në pajisjet elektrike, makineritë dhe materialet e ndertimit.

DPM ka organizuar aktivitete promovuese dhe sensibilizuese për metrologjinë (Dita Botërore e Metrologjisë 20 Maj, botime informuese si fletë palosje, botime, postera, takime informative me palët e interesuara, etj) si dhe periodikisht ka realizuar botime gazetës periodike Metrologjia.

## 10. Kontratat e prokurimit të nënshkruara dhe të realizuara

Nr.	Objekti i Kontratës	Emri i kontraktorit	Vlera e kontratës së nënshkruar /fatura tatimore	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të lidhjes së kontratës
1	Shërbim i transportit të punonjësve të institucionit me autobus	Zenith Travel NIPT: L12212026G	1,999,800.0	22.01.2024	31.12.2024
2	Riparim, mirëmbajtje automjeteve për DPM	Alstezo NIPT: J63208420N	132,000.0	06.02.2024	20.02.2024
3	Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (gazoil)	Kastrati shpk & Kastrati Group sha NIPT J61813529P & NIPT K21711502V	3,750,000.0	26.09.2024	31.12.2024
4	Mirëmbajtje e websitit të DPM-së	Evolve web Studio NIPT: L72429007F	169,990.0	03.01.2024	31.12.2024
5	Shërbim interneti	Vodafone Albania NIPT:K11715005L	150,000.0	03.01.2024	31.12.2024
6	Për sigurimin e godinës së DPM-së, nga zjarri, uji dhe tërmeti	Ansiga sha NIPT: L21319037M	800,000.0	04.03.2024	31.12.2024
7	Për sigurimin e mjeteve të transportit	Ansiga sha NIPT: L21319037M	800,000.0	04.03.2024	31.12.2024
8	Blerje tretësirë referuese të alkoolit	Medfau shpk NIPT:J93610823R	37,500.0	04.03.2024	-

9	Blerje uji të pijshëm për punonjësit e DPM-së, në zyrat qendrore	Lajthiza Invest Sha Nipt:J98009202P	133,000.0	26.03.2024	27.12.2024
---	--	--	-----------	------------	------------

## 11. Realizimi i buxhetit per vitin 2024

Treguesit e DPM-së sipas llogarive deri më 31.12.2024.

Llogari ekonomike	Emertimi	Plani buxhetor vjetor 2024	Realizimi faktik 2024 (leke)
600	Fondi i pagave	109,235,889	108,896,245
601	F.sigurimeve shoq.	18,264,111	18,264,111
602	F. shpenz operative	33,200,000	25,387,490
605	F. antar.org. nderkomb	3,500,000	3,473,103
606	F. ndihma ekonomike	543,000	524,000
602	Shpenz nga ardh.j.limit	10,000,000	5,126,009
466	TVSH e paguar		15,449,449
231	Investime	0	0

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
(I komanduar)

Erinda Piluri

